


FËMIJËT



RAPORTOJNË

FORMA MË E MIRË E QEVERISJES

ILIRA (10), GJENIS (10), EMIRJON (10), VESA (10)



Përshëndetje të dashur, ne jemi nxënësit gazetarë dhe jemi nga shkolla „Nazim Gafurri“. Sot në artikullin tonë do të flasim për demokracinë

Të nderuar lexues, ne sot do t'iu flasim pak për demokracinë. Demokracia për herë të parë u shfaq në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë së lashtë. Viti i lindjes së demokracisë është viti 507 para erës sonë.

Në atë kohë, gratë nuk kanë pasur të drejtë të mblidhen për të diskutuar për vendin e tyre. Kjo do të thotë se vetëm burrat mbi moshën 18 vjeçare e kishin këtë të drejtë. Nuk kanë pasur të drejtë të merrnin pjesë as të varfërit, as të moshuarit dhe as ata të cilët nuk ishin banorë të qytetit të Athinës.

Ndoshta ju doni të dini se çfarë kuptimi ka fjala demokraci. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Nga kjo kuptojmë se populli ka udhëheqjen në dorë. E kundërta e kësaj është autokracia, në të

cilën udhëheq vetëm një njeri, i cili quhet mbret. Neve kjo formë e udhëheqjes nuk na pëlqen fare, sepse të gjithë duhet të japim mendime për një vend sa më të mirë. Kjo ndodh në demokraci. Këtu ne kemi shumë të drejta.

Tani do të flasim për një të drejtë shumë të rëndësishme, e cila është e drejta e votimit. Kjo e drejtë sot iu takon të gjithë qytetarëve. Iu takon grave, të moshuarve, të varfërve, personave me nevoja të veçanta, personave që jetojnë në fshatra, në qytete dhe të gjithë qytetarëve, të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare. Në demokraci janë dy lloje të zgjedhjeve. Kemi zgjedhjet komunale apo lokale dhe zgjedhjet parlamentare apo qendrore. Këto janë shumë të rëndësishme që ne të kemi demokraci të mirëfilltë. Por, edhe pse ne fëmijët nuk e njohim edhe aq këtë proces, shokët tanë kanë vendosur që në artikullin tjetër të shkruajnë për zgjedhjet ku ne si fëmijë marrim pjesë.



Të angazhuar dhe demokratikë jemi ne



Duke bashkëpunuar arrijmë gjithçka që ëndërrojmë

PROCESI MË DEMOKRATIK

SARA (10), ARDITI (10), BLERTI (11), SUELA (10)

Ne jemi grupi i cili kemi folur për zgjedhjet. Kjo temë është shumë interesante për ne fëmijët. Prandaj, ne gazetarët kemi vendosur të flasim për procesin më demokratik që ndodh në Kosovë. Po ashtu, do të flasim për zgjedhjet e fëmijëve, që po ashtu janë demokratike. Ju ftojmë ta lexoni artikullin tonë

Këtë artikull e kemi titulluar: "Procesi më demokratik,,. Por, pse kemi vendosur që t'ia lëmë pikërisht këtë emër? Kështu kemi vendosur, sepse ne mendojmë se zgjedhjet janë procesi më i rëndësishëm, i cili ndodh në shtetin tonë të dashur. Këtë proces e kemi të pranishëm në jetën tonë gati se për çdo ditë. Ne zgjedhim që nga momenti që i hapim sytë në mëngjes. Pasi të zgjohemi, pastrojmë fytyrën, pastrojmë dhëmbët dhe i zgjedhim rrobat që do t'i veshim përgjatë ditës. Ne po ashtu, zgjedhim edhe ushqimin që dëshirojmë ta hajmë. Pasi të mbarojmë mësimin dhe detyrat e shtëpisë, ne bashkë me fëmijët e tjerë të lagjes zgjedhim se cilën lojë do ta luajmë. Loja që e luajmë më së shpeshti është loja kukafshehtas. Por, vendi ku më së shumti zgjedhim është klasa jonë.

Para dy javëve, ne patëm rastin të zgjedhim kryesinë e klasës. Nxënësit e klasës kanë propozuar nxënësit më të mirë për të kandiduar. Nga ta, ne është dashur të votojmë për kryetarin, sekretarin, arkatarin dhe anëtarin e klasës sonë. Anëtari i klasës është një nxënës, i cili ndihmon kryetarin. Këto vota ishin vota të hapura, ku secili mund të shikonte tjetrin duke votuar. Mësuesja jonë numëronte votat dhe në fund ne zgjodhëm Ilirën, Delfinën, Suelën dhe Tefikun. Gjithashtu, atë ditë ne votuam për Komisionin e Lëvdatës dhe Komisionin e Dënimit. Edhe ky ishte votim i hapur. Ndërsa, për Komisionin e Pastërtisë ishte votim i mbyllur. Ne edhe pse jemi fëmijë dhe nuk kemi të drejtën të marrim pjesë në zgjedhje shtetërore, ashtu siç e patë, bëjmë shumë zgjedhje të ndryshme.




Me duart tona ne ndërtojmë demokracinë



Kandidatët duhet të tregojnë planet e tyre për vendin




Votuesit duhet të jenë të informuar për kandidatët



Kutia më e mirë që ekziston, kutia e votës

RREGULLAT E SHTETIT TONË - LIGJET


ALTIJON (11), FATBARDHË (10), ARIJANIT (10) ALBIN (11), RIJETA (10), TEFIK (10), ALMIR (10),
JAKUP (11)



Megenëse
ne jemi shtet sovran
dhe demokratik, para ligjit
të gjithë jemi të barabartë pa
asnjë dallim

Rregullat e shtetit vendosen nga përfaqësuesit e popullit. Këta përfaqësues quhen deputetë

Çdo familje ka rregulla të cilat duhet të respektohen. Këto rregulla vendosen nga vetë anëtarët e familjes. Në familjen time ka shumë rregulla, por njëri do ta ndajmë me ju. E ajo është që të gjithë të ushqehemi së



Në Kuvend për t'u miratuar një projektligj, duhet votuar

bashku në kohën e njëjtë dhe kur përfundojmë ushqimin, secili prej nesh e largon pjatën e vet nga tryeza. Edhe në shkollën tonë ka rregulla, të cilat janë vendosur nga drejtori i shkollës sonë në pajtim me mësimdhënësit.

Është obligim që të gjithë nxënësit e shkollës sonë të vishen me uniformë. Në fakt, kjo është rregull shumë e mirë, sepse me anë të uniformës ne të gjithë identifikohemi si nxënës të shkollës „Nazim Gafurri“. Por, ne

gjithashtu me anë të uniformës tregojmë se të gjithë jemi të barabartë dhe pa asnjë dallim.

Ne i cekëm disa rregulla, të cilat i kemi në shtëpi dhe në shkollë. Mirëpo, ne kemi edhe rregulla, të cilat kërkojnë të respektohen nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Këto rregulla quhen ligje. Ligjet dalin nga një institucion shumë i rëndësishëm, i quajtur Kuvend. Këto ligje kanë për qëllim që të na e rregullojnë dhe përmirësojnë jetën neve si qytetarë. Në Kuvend, punojnë përfaqësuesit e popullit, të cilët kanë për detyrë të miratojnë ligje.

Tek ne ekziston ligji për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut nga veprimet e paligjshme të organeve dhe autoriteteve të Kosovës. Në këtë rast, qytetarët mbrohen nga Avokati i Popullit.

Ligjet bëhen për ne, prandaj ne duhet t'i respektojmë ato.



Puna e palodhshme e jona në emër të demokracisë

DEMOKRACIA ËSHTË E VLEFSHME

DEFLINA (10), ERIS (11), ERBLIN (10), LEDION (9), KREMTIM (10), ELVIRA (11), SARA (10)



Demokracia është forma më e mirë e udhëheqjes së një shteti. Kosova e ka këtë formë të qeverisjes dhe ne jemi të lumtur që falë saj kemi mundësi të vizitojmë këtë Punëtori

Ne jemi qytetarë të Republikës së Kosovës. Jemi qytetarë të barabartë pa dallim feje, gjinie, etniteti, etj. Këtë na e mundëson demokracia, e cila është forma më e mirë e qeverisjes së një vendi.

Por, demokracia e vetme nuk mund të funksionojë. Ajo nuk mund të mbijetoj gjatë pa ndihmën e qytetarëve, dhe jo vetëm qytetarëve dosido, por qytetarëve aktiv. Qytetarët aktiv janë ata të cilët e ndihmojnë demokracinë të funksionojë më mirë. Në këtë mënyrë edhe vendi në të cilin qytetarët aktiv jetojnë funksionon më mirë. Një shembull i qytetarëve aktiv është edhe kërkesa që disa banorë të një lagjeje ia kanë bërë kryetares së Komunës së tyre në mënyrë që t’iu përmirësohet jeta e tyre në lagjen ku jetojnë. Qytetarët kanë paralajmëruar se nëse nuk merret pa-

KËRKESË

E dashura kryetare e Komunes në qytetin tonë të dashur. Ne jemi banorët e lagjes Evlia Çelebiu. Ne kërkojmë nga ju që ta vizitoni lagjen tonë dhe ta shihni se nuk është në aiendie të mirë.

Në lagjen tonë mungon një rrugë e shtruar dhe për këtë arsye po kemi vështirësi të lëvizim sidomos në dimër. Mungojnë shportat, për këtë arsye ka shumë mbeturina në tokë. Mungon një park për të lozur fëmijët dhe gjithashtu një hapësirë për t’i parkuar veturat.

Kërkojmë nga ju që të ndërmerrni iniciativë për rregullimin e këtyre problemeve.

Ju faleminderit.

Ne jemi banorët e lagjes "Elvia Çelebiu"

Eris Avdiu,
Delfina Gashi,
Elvira Abdullahu,
Naim Robelli,
Erblin Bislimi,
Ledion Hajdari,
Kremtim Krasniqi,
Sara Gashi

rasysh kërkesa e tyre, ata do të shfrytëzojnë forma të tjera demokratike për t’iu plotësuar kërkesa, siç janë protestat paqësore.



Aktivizimi qytetar



Autorët e këtij artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë